



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 599/1 Prot.

Tiranë, më 15.11.2016

V E N D I M
Nr. 123, datë 15.11.2016

***“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 599 prot., datë 29.09.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreun II, neni 21, dhe Kreu X, nenet 77-97 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas marrjes dijeni nga informacioni i dërguar prej Bashkisë Klos, për disa parregullsi të konstatuara si dhe me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, me aktin nr. 599 prot., datë 29.09.2016, “Për verifikimin e ligjshmërisë së procesit të rekrutimit në shërbim civil, në Bashkinë Klos”, ka filluar kryesisht verifikimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në këtë institucion.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në Bashkinë Klos nga grupi i punës, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Institucioni u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 599/1 prot., datë 29.09.2016 “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se, Bashkia Klos është organ i qeverisjes vendore i konstituuar pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 dhe organizohet e funksionon, bazuar në ndarjen administrativo-territoriale (në rubrikën Qarku Dibër, Qyteti Klos), të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas përcaktimeve të ligjit të mësipërm, kjo njësi e qeverisjes vendore përbëhet nga Bashkia Klos me 4 (katër) Njësitë Administrative në varësi të saj, të cilat janë, Klos, Xibër, Suç dhe Gurrë (këto të fundit, ish-Komuna, të cilat janë shkrirë në të).

Në momentin e inspektimit, Këshilli i Bashkisë Klos, me aktin administrativ nr. 75, datë 28.01.2016 “Për Miratimin e strukturës dhe nivelin e pagave në Bashkinë Klos për vitin 2016”, ka përcaktuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Klos dhe Njësive Administrative nën varësinë e saj.

Në vijim të zbatimit të këtij vendimi, rezulton se kryetari i Bashkisë Klos bazuar në nenin 64, gërma “j”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, ka nxjerrë Urdhrin nr. 51/2, datë 01.09.2016, për miratimin dhe implementimin e strukturës dhe organigramës të këtij institucioni.

Sipas strukturës së miratuar në këtë bashki dhe njësitë administrative në varësi të saj, janë në total **202** pozicione pune, ndër të cilët **56** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet kur, nga ana e njësive përgjegjëse të burimeve njerëzore të institucionit, nuk ishin përcaktuar në strukturë, pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil, si dhe duke pasur parasysh faktin se mungonin përshkrimet e punës, ky numër ka dalë si analizë e grupit të inspektimit, duke u bazuar në emërtesën e pozicioneve të punës të përcaktuar në strukturën e bashkisë, detyrat funksionale që kryenin realisht, si dhe kategoritë e pagës në këto pozicione.

Gjatë procesit të verifikimit në institucion, u konstatuan parregullsi të ndryshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil, ndër të cilat:

- Referuar nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Klos dhe ato të ish komunave, që aktualisht janë njësi administrative në varësi të kësaj Bashkie, nuk janë shprehur në lidhje me statusin e punësimit për asnjë nga punonjësit që punonin në një vend pune, pjesë e shërbimit civil. Referuar gremës “c”, Kreu IV, të Vendimit nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, aktualisht njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Klos, ka marrë funksionet e organit përgjegjës për personelin e ish-Komunave të riorganizuar pranë saj, dhe ende nuk e ka përmbyllur këtë proces.
- Konstatohen emërime në vende pune pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, në lidhje me këto raste, me shkresën nr. 302/1 prot., datë 17.02.2016, Bashkia Klos ka deklaruar se në këtë mënyrë, janë plotësuar **8** pozicione pune.

Nga verifikimet e kryera në subjekt nga grupi i punës, rezulton se aktualisht janë **19** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akt emërimi apo kontratë të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele, e ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit më të lartë në hierarkinë e administrimit të shërbimit civil. Konkretisht, në shkelje të ligjit, janë kryer emërimet për punonjësit, si më poshtë:

1. *****, në pozicionin, “*Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh*”, emëruar me Vendimin nr.3, datë 12.02.2015;
2. *****, në pozicionin, “*Inspektor i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës*”, emëruar me Vendimin nr.2, datë 12.01.2015;
3. *****, në pozicionin, “*Audit i Brendshëm*”, emëruar me kontratën, datë 16.10.2015;
4. *****, në pozicionin, “*Inspektor Shërbimesh*”, emëruar me kontratën, datë 16.10.2015;
5. *****, në pozicionin, “*IT*”, emëruar me kontratën, datë 16.10.2015;
6. *****, në pozicionin, “*Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Teritori*”, emëruar me kontratën, datë 16.10.2015;
7. *****, në pozicionin, “*Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës*”, emëruar me Vendimin nr.21, datë 02.06.2016;
8. *****, në pozicionin, “*Inspektor i Arsimit Kulturës Rinisë e Sportit*”, emëruar me Vendimin nr.27, datë 13.06. 2016;
9. *****, në pozicionin, “*Inspektor i Barazisë Gjinore*”, emëruar me Vendimin nr.26, datë 13.06.2016;
10. *****, në pozicionin, “*Drejtor i Drejtorisë Zhvillimit të Teritorit*”, emëruar me Vendimin nr.29, datë 15.06.2016;
11. *****, në pozicionin, “*Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Teritori*”, emëruar me Vendimin nr. 35, datë 23.06,2016;
12. *****, në pozicionin, “*Specialist Jurist*”, emëruar me Vendimin nr.36, datë 28.06.2016;
13. *****, në pozicionin, “*Inspektor i Shërbimeve*”, emëruar me Vendimin nr 39/1, datë 14.07.2016;

14. *****, në pozicionin, “*Inspektor Finance*” për Ujësjetësin, emëruar me Vendimin Nr.39, datë 07.07.2016;
15. *****, në pozicionin, “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, emëruar me Vendimin nr. 37, datë 01.07.2016;
16. *****, në pozicionin, “*Inspektor Shërbimesh dhe Mjedisi*”, emëruar me Vendimin nr.45, datë 28.07.2016;
17. *****, në pozicionin, “*Përgjegjës i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit*”, emëruar me Vendimin nr.59, datë 01.09. 2016;
18. *****, në pozicionin, “*Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit*”, emëruar me Vendimin nr.56, datë 01.09. 2016;
19. *****, në pozicionin, “*Përgjegjës i Emergjencave Civile*”, emëruar me Vendimin nr.57, datë 01.09.2016.

Në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se :

- Këta punonjës, aktualisht vazhdojnë të jenë në marrëdhënie pune të kundërligjshme me këtë institucion, marrëdhënie të cilat njësia përgjegjëse, i justifikon me kushtet e emergjencës në të cilën ndodhet Bashkia Klos, për kryerjen e detyrave.
- Njësia përgjegjëse nuk ka hartuar planin e punës së rekrutimeve, “*Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil, për vitin 2016*”, e po kështu, nuk u evidentua asnjë vendimarrje apo veprime konkrete për të zhvilluar procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, pasi të largohen punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin.

Në këto rrethana, Kryetari i Bashkisë Klos, në rastet e evidentuara më sipër, ka shkelur procedurën e nxjerrjes së aktit të emërimit në shërbimin civil, të parashikuar në legjislacionin në fuqi, gjë që në vështrim të nenit 108, pika ii) të germës a), të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, e bën aktin absolutisht të pavlefshëm.

Po kështu, edhe në vështrim të nenit 109, pikat b) dhe d) të këtij ligji, si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën administrative, si edhe nxjerrjes së këtyre akteve në kundërshtim të ligjit material, aktet konsiderohen të paligjshme.

Në vijim të këtij arsytimi, bazuar në nenin 110, pika 1, të ligjit në fjalë, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo, si i tillë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 23, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe nenin 111, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës*”

së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Klos, duhet të konstatojë ekzistencën në këtë veprim administrativ të rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 113 të po këtij ligji, të bëjë anulimin e akteve administrative të cituara më sipër, për emërimin në detyrë të **19 (nëntëmbëdhjetë)** punonjësve, si akte administrative absolutisht të pavlefshme të nxjerra në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji për shërbimin civil.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”; e nenin 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

T’i kërkoj njësisë përgjegjëse, që për rregullimin e ligjshmërisë, në rastet e emërimeve në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil pa kryer procedurat e konkurrimit, të zbatojë detyrat si më poshtë:

1. Fillimisht, njësia përgjegjëse duhet të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në faktin se ato ushtrojnë funksione publike, si dhe duke analizuar funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës. Këto përcaktime, duke përjashtuar rastet e parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duhet t’i specifikojë në mënyrë të shprehur edhe në strukturën e institucionit.
2. Njësia përgjegjëse, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, dhe të nxjerrë aktin e deklarimit të punësimit në shërbim civil për punonjësit, që rezultojnë se i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
3. Pas përfundimit të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse për plotësimin e **19 (nëntëmbëdhjetë)** pozicioneve të punës, duhet të ndjekë këtë rend veprimesh:

Së pari, njësia përgjegjëse, duhet të drejtojë procesin e anulimit të akteve administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm për punonjësit, si më poshtë :

- Aktin nr. 3, datë 12.02.2015, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh*”.
- Aktin nr. 2, datë 12.01.2015, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin, “*Inspektor i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës*”.
- Aktin nr.21, datë 02.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës*”.
- Aktin nr.27, datë 13.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Inspektor i Arsimit Kulturës Rinisë e Sportit*”.
- Aktin nr.26, datë 13.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin, “*Inspektor i Barazisë Gjinore*”.
- Aktin nr.29, datë 15.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Drejtor i Drejtorisë Zhvillimit të Teritorit*”.
- Aktin nr.35, datë 23.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Territori*”.
- Aktin nr.36, datë 28.06.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Specialist Jurist*”.
- Aktin nr.39/1, datë 14.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin, “*Inspektor i Shërbimeve*”.
- Aktin nr.39, datë 07.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësës ***** , në pozicionin, “*Inspektor Finance*”.
- Aktin nr.37, datë 01.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Specialist i Ndihmës Ekonomike*”.
- Aktin nr.45, datë 28.07.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Inspektor Mjedisi dhe Shërbimesh*”.
- Aktin nr.59, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Përgjegjës i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit*”.
- Aktin nr.56, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “*Inspektor i Arsimit, Kulturës, Rinisë e Sportit*”.

- Aktin nr.57, datë 01.09.2016, për emërimin në detyrë të punonjësit ***** , në pozicionin, “Përgjegjës i Emergjencave Civile”.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Audit i Brendshëm*”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Inspektor Shërbimesh*”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*IT*”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Kontratën e punës, datë 16.10.2015, për punonjësën ***** , emëruar në detyrë në pozicionin “*Inspektor Shërbimesh dhe Kontroll Territori*”, në të cilin është specifikuar edhe data e fillimit të marrëdhënieve financiare.

Së dyti, të verifikojë nëse ndonjë prej punonjësve që e gëzojnë statusin e nëpunësit civil nga **4** (*katër*) ish-Komunat apo Bashkia, i plotëson kërkesat për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira. Nëse rezulton ndonjë rast i tillë, të kryejë emërimin e tij pa konkurrim në atë pozicion.

Së treti, të verifikojë listën e punonjësve të dalë në lirim nga shërbimi civil, pas ristrukturimit të institucionit dhe nëse ndonjë prej tyre plotëson kërkesat e vendit të punës, për të punuar në ndonjë prej pozicioneve të lira, të emërohet në atë pozicion, pa konkurrim.

Së katërti, pasi të ketë ezauruar tre hapat e parë, të shpallen procedurat e konkurrimit për pozicionet që do të rezultojnë ende të lira.

4. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2016, planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
5. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil, pasi të jetë respektuar rendi i veprimeve të përcaktuara më sipër.

6. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.
7. Në veçanti, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:
- ✓ Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimi dhe vlerësimit (*Komiteti i Përhershëm i Pranimi për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë*) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (*përveç lëvizjes paralele*) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
 - ✓ Të bëjë publik në faqen zyrtare, “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Klos, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet që kërkohen nga ligji dhe aktet nën ligjore, për të materializuar procedurat e rekrutimit, të tilla si:
 - Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat, e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimi (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjor që duhet të përmbajë shpallja.
 - Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranimi në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (*lista përfundimtare*) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu edhe për fazën e dytë “*pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë*”.
 - Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.
8. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Klos, të zbatojë vendimin brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati, të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative që janë kryer dhe masat e marra, për zbatimin e këtij vendimi.
 9. Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurremeve, si dhe për çdo problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e shërbimit civil, të komunikojë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe të kërkojë asistencën e nevojshme, me qëllim realizimin e këtyre proceseve në përputhje me ligjin.
 10. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia Klos.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA